

VENDIM
Nr.5, datë 7.1.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.96, DATË 3.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E AKTIVEVE, NË MBULIM TË PROVIGJONEVE,
TEKNIKE DHE MATEMATIKE, DHE TË KUFIJVE MAKSIMALË TË INVESTIMEVE TË
TYRE NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.96, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 4, shprehja “...20% të provigjoneve, teknike dhe matematike,...” zëvendësohet me “...30% të provigjoneve, teknike dhe matematike,...”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha